

RREGULLAT E PROMOCIONIT "SAMSUNG GALAXY Z FOLD5 dhe Z FLIP5"

Përpara se të blini një prej pajisjeve, ju lutemi njihuni me këto rregulla të para-shitjes (në vijim "**Rregullat**"):

1. Organizator i para-shitjes

Samsung Electronics Austria GmbH, me zyrën e saj të regjistruar në Vjenë në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri dhe numrin e regjistrimit FN 217924b (në vijim "**Samsung**") organizon para-shitjen e pajisjeve Samsung Galaxy Z Fold5 dhe Z Flip5 .

2. Periudha e para-shitjes dhe pajisjet

Subjekt i para-shitjes janë pajisjet Samsung Galaxy Z Fold5 12/512* dhe Z Flip5 8/512** (në vijim veçmas "**Pajisja**" dhe bashkërisht "**Pajisjet**"). Para-shitja është në dispozicion për blerësit e Pajisjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë në periudhën nga 26.07.2023 deri më 10.8.2023 ose më herët nëse përfundon stoku (në tekstin vijim: "**Periudha e Para-shitjes**").

* 12 GB RAM dhe 512 GB memorie

** 8 GB RAM dhe 512 GB memorie

Modelet me memorie 1 TB nuk përfshihen në këtë Promocion.

3. Përfitimet

Nëse plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në këto Rregulla, blerësi i Pajisjes ka të drejtë të blejë një Pajisje me dy herë më shumë memorie për ruajtjen e të dhënave me çmimin e modelit bazë të Pajisjes si më poshtë:

- fitoni të drejtën për të blerë Samsung Galaxy Z Fold5 12/512 me çmimin e Samsung Galaxy Z Fold5 12/256 (modeli bazë), ose
- fitoni të drejtën të blini Samsung Galaxy Z Flip5 8/512 me çmimin e Samsung Galaxy Z Flip5 8/256 (modeli bazë).

4. Kushtet e blerjes për të realizuar të drejtën e përfitimeve nga pika 3 e Rregullave

Blerja e Pajisjes mund të bëhet tek partnerët e shitjeve të Samsung të renditur në pikën 6 të këtyre Rregullave, në kushtet e mëposhtme kumulative:

- a. Që blerësi të blejë Pajisjen gjatë Periudhës së Para-shitjes;
- b. Blerësi të blejë Pajisjen në faqen e internetit ose në një dyqan me pakicë te një partner i autorizuar i shitjeve Samsung në territorin e Republikës së Shqipërisë; Lista e partnerëve të autorizuar përcaktohet në pikën 6 të këtyre rregullave;
- c. Blerësi të blejë Pajisjen si përdorues fundor; Përdoruesit fundorë janë personat fizikë dhe juridikë nga territori i Republikës së Shqipërisë të cilët e blejnë pajisjen për nevojat e tyre dhe jo për nevojat e rishitjes ose shpërndarjes së mëtejshme;

5. Marrja në dorëzim i Pajisjes

Të gjithë blerësit që blejnë një Pajisje gjatë Periudhës së Para-shitjes do të mund ta marrin atë nga një partner i shitjeve të Samsung, duke filluar nga 11.08.2023.

Shitja e rregullt e Pajisjes fillon më 11.08.2023.

6. Partnerët e autorizuar të shitjeve të Samsung

Shitja paraprake e pajisjeve Samsung mund të bëhet vetëm tek partnerët e mëposhtëm të autorizuar të shitjeve të Samsung:

One Telecommunications Sh.a.

Neptun SH.P.K.

Globe Shops SH.P.K.

Vodafone Albania Sh.a.

7. Të dhënat personale të blerësit

Për qëllimin e zbatimit të këtij Promocioni, Samsung nuk mbledh ose përpunon të dhënat personale të blerësit.

8. E drejta për të ndryshuar Rregullat

Samsung rezervon të drejtën të bëjë ndryshime në këto Rregulla për arsye të justifikuara, me detyrimin për t'i publikuar ato pa vonesë.

Këto rregulla janë publikuar më 26.07.2023 në faqen <https://www.samsung.com/al/offer/preorder-galaxy-z-fold5-z-flip5/> datë nga e cila hyjnë në fuqi.